



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2298/2 Prot.

Tiranë, më 21.09.2023

V E N D I M

Nr. 59 datë 21.09.2023

P Ë R

**NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN NR 48 DATË 30.06.2023 "PËR MIRATIMIN E
PAGAVE TË PUNONJËSVE NDIHMËS AKADEMIK ME KARAKTER
ADMINISTRATIV DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE
TË TIRANËS"**

Bordi i Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, mbështetur në:

- Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë";
- VKM NR.123, datë 17.02.2010, Për Krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës"
- Ligji nr.10/247 "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", të ndryshuar;
- Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 27, datë 29.12.2017" Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit të Lartë"
- Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07.datë 01.02.2023 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023, në Universitetin e Sporteve të Tiranës;
- VKM nr.325 datë 31.05.2023" *Për miratimin e strukturës së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarë të kabineteve, perfektit, nënprefektit,nëpunësve civil dhe nëpunësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"* VKM nr.326, datë 31.05.2025 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike"
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.16, datë 16.06.2023 "Për mënyrën e zbatimit të VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, dhe të niveleve të pagave nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike" të sugjerimit të MAS përcjell përmes e-mail të datës 29.06.2023 dhe në Relacionin nr. 1682/1 prot, datë 30.06.2023, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë/Protokollit dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të UST, shkresën nr.2092 prot, datë 04.09.2023, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit "Rishikim i shkallës së vështërsisë",Bordi i Administrimit në mbledhjen e dates 21.09.2023,

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të Vendimit nr.48 datë 30.06.2023 mbi "Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, të Univeristetit të Sporteve të Tiranës , sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi, korrigojohet si më poshtë vijon:
 - Në pasqyrën nr. 2 në rreshtin e dytë "Teknik i mesëm i Specialiteteve të Ndryshme" shkalla e vështirësisë së dëmshmërisë, korrigojohet me shkallën e II-të dhe shkallën e III-të.
 - Në pasqyrën nr. 2 në rreshtin e tretë "Punonjës mirëmbajtje " korrigojohet me shkallën e I-rë dhe shkallën e II-të.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi; Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të UST.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

